



Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivered	31.01.2022	3	viti god year
Organ /Njesia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	1162/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1119/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1119/2022 të datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Zyra e Rregullatorit për Energji, në çështjen juridike "kontestimi konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1119/2022 e datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet njoftimi i datës 25.10.2022 përmes e-mailit zyrtar për refuzimin e aplikacionit të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Zyrës e Rregullatorit për Energji dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë.
- III. Obligohet Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Zyrës e Rregullatorit për Energji që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses të datës 05.10.2022.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 08.12.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1119/2022 me numër protokoll 7775/2022, kundër njoftimit të datës 25.10.2022 lidhur me procedurën e rekrutimit të datës 16.09.2022 për pozitën Analist për përmbushje të standardeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.12.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji. Ndërsa, Këshilli më datë 12.01.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë përmes e-mailit zyrtar bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7775/2022 të datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e datës 16.09.2022; Verifikimi paraprak i kandidatëve i datës 17.10.2022 me nr.453/22; Njoftim i datës 25.10.2022; Vërtetim i datës 04.07.2022 i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Vërtetim i datës 04.07.2022; Pasqyra e llogarisë për trustin prej datës 15.11.2015 deri më datë 29.06.2022; Diplomë e datës 12.11.2015 me nr.67 lëshuar nga Fakulteti Juridik , Qendra në Gjilan; Vërtetim i datës 27.09.2019 e vërtetuar te noteri; Diploma Master e datës 29.01.2018 me nr.1576 e lëshuar nga Fakulteti Juridik e vërtetuar te noteri me datë 14.05.2018; CV për Shpresa Musliu; Çertifikatë e muajit dhjetor 2018; Çertifikatë e datës 22.05.2019 e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë me të cilën dëshmohet se ka dhënë provimin e Jurisprudencës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 16.12.2022; Përgjigje në ankesë e datës 11.01.2023 nga organi i punësimit përmes e-mailit zyrtar e protokolluar me nr.206/2023 me datë; E-mail zyrtar nga DMZP; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Analist/e për Monitorim të Tregut e datës 23.08.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Analist/e për Energji termike e datës 23.08.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Analist /e për Përmbushje të Standardeve e datës 23.08.2022; Aplikacioni i datës 05.10.2022 me nr.ref.RN00009878; Refuzimi i aplikacionit; Vendimi i datës 19.05.2016 i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë; Vendimi i datës 23.06.2016 i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë; Skema e pagave e harmonizuar me vendimin e Bordit të ZRRE-së për skemën e re organizative; Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës Zyrtar për Asistencë të Bordit dhe Refuzimi i Aplikacionit përmes ISMBNJ.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Zyra e Rregullatorit për Energji më datë 16.09.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të Konkursit me numër reference RN00009878 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Analist për përmbushje të standardeve", e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesja. Në fazën e verifikimit paraprak, Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Rregullatorit për Energji, më datë 25.10.2022 përmes e-mailit zyrtar dhe

SIMBNJ, ka njoftuar ankuesen për refuzimin e aplikacionit me arsyetimin se e njëjta është Zyrtare për asistencë të Bordit dhe nuk i përket grupit të analistëve sipas vendimeve të Bordit të zyrës së Rregullatorit për Energji .

Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Rregullatorit për Energji me datën 30.10.2022 ka kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për caktimin e pozitave analistëve në SIMBNJ, me 30.10.2022 zyrtarja nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes përgjigjes ka deklaruar se pozita Analist për Përmbushje të Standardeve është Profesional 1, ndërsa në konkursin e shpallur me datën 16.09.2022 të njëjtën pozitë e ka klasifikuar Profesional 2.

Brenda afatit ligjor ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit, ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, meqenëse ankuesja pretendon se njoftimi për refuzimin e aplikacionit nuk ka pasur këshill juridike e njëjta me rastin e parashtrimin të ankesës ka vepruar në pajtim me nenin 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative ku përcaktohet se " 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht :Ligjin Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publikë, neni 38 me të cilin është përcaktuar se: "*Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji...."*

Kolegji i këshillit në lidhje me këtë lëndë poashtu ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 40 ku thuhet se: "*....2. Lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për secilën pozitë të lirë. 3. Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil..., nenin 41 ku parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2. Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e*

shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë” dhe nenin 45 ku theksohet se” 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ.

Po ashtu nga provat e bashkangjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja fare nuk ka parashtruar ankesë me rastin e refuzimit të aplikacionit, këtë e ka cek edhe Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Rregullatorit për Energji, mirëpo në këtë rast Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Rregullatorit për Energji, ka vepruar në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se : “5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 6.Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”. Andaj Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në këtë rast nuk ka nxjerr fare vendim por edhe në njoftimin të cilin ja ka përcjell ankueses nuk ka pasur fare këshill juridike ku përcaktohet afati se kur ankuesja duhet të paraqes ankesë kundër njoftimit për refuzimin e aplikacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se edhe për faktin se në Aplikacionin e refuzuar të gjitha kriteret e konkursit që janë cek ankuesja i ka plotësuar : kriterin formal për pozitën Profesional 1, ku kërkohet arsimimi prej 240 kredive/ECTS, 60 kredië/ECTS në nivelin master dhe më datën 22.05.2019 ka dhënë provimin e jurisprudencës, ndërsa sa i përket kriterit të përvojës së punës ankuesja prej vitit 2016 është e punësuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji në pozitën e Zyrtares për asistencë të Bordit, ndërsa që nga viti 2020 ankuesja me vendime të veçanta të Bordit është e ngarkuar me detyra shtesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve e që përshkrimi i detyrave të punës është i njëjtë me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Analist për përmbushje të standardeve.

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Rregullatorit për Energji me rastin e nxjerrjes se njoftimit për refuzimin e aplikacionit të datës 05.10.2022 me nr.ref.RN00009878 ,gabimisht ka zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, konstaton se njoftimi për refuzimin e aplikacionit është i mangët dhe po ashtu mos nxjerrja e vendimit është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që Njësia e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Rregullatorit për Energji në ri procedurë duhet të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1119/2022, datë 31.01.2023

Sabile AVDYLI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Rregullatorit për Energji; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.